



UNIVERSITETI I GJAKOVËS
"FEHMI AGANI"
UNIVERSITY OF GJAKOVA

Kryesuesi i Këshillit Drejtues
Dr.Sc. Mazllom Kumnova

Nr.prot.: 05/1922
Datë: 16/12/2020

Këshilli Drejtues i Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani", bazuar në nenin 12, paragrafi 1, pika 1.15 dhe nenin 22, paragrafi 1, pika 1.5, të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani", në mbledhjen e mbajtur me datë 16.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

- I. Themelohet Qendra Universitare për Këshillime Psiko-sociale, e Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani".
- II. Funkcionimi i kësaj Qendre do të bëhet duke u bazuar në Rregulloren e Qendrës për Këshillime Psiko-sociale e Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani", në pajtim me procedurat dhe kushtet e përcaktuara me Ligjin për Shëndetësi dhe aktet e tjera përcjellëse.
- III. Autorizohet menaxhmenti i Universitetit të Gjakovës që t'i ndërmarr veprimet e nevojshme dhe t'i koordinojë aktivitetet për sigurimin e kushteve ligjore për themelimin dhe funksionalizim e Qendrës Universitare për Këshillime Psiko-sociale, në pajtim me procedurat dhe kushtet e përcaktuara me Ligjin për Shëndetësi dhe aktet përcjellës nënligjore.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues.

A r s y e t i m

Këshilli Drejtues duke pasur parasysh rëndësinë e një Qendre Universitare për Këshillime Psiko-sociale, e cila synon të ndihmojë stafin si dhe studentët e Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani", nëpërmjet këshillimeve të cilat do të ofrohen nga psikologë të Qendrës vendosi për themelimin e saj. Kjo Qendër ka si element kyq shëndetin mendor dhe mbështetjen psikosociale, prandaj në mbledhjen e mbajtur me datë 16.12.2020, u vendos si në dispozitiv të këtij vendim.

Ky vendim i dorëzohet:

- 1.Menaxhmentit të UGJFA-së;
- 3.Sekretarit të Përgjithshëm;
- 4.Njësive Akademike;
- 5.Arkivit të UGJFA-së.



Kryesuesi i Këshillit Drejtues

Dr.Sc. Mazllom Kumnova